

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – Departamenti për krime të rënda - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi , kryetari i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Afrim Shala anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale,Syzana Goxhuli si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarit B.S. nga fshati .., komuna e Istogut, për shkak të veprës penale Grabitja nga nenin 329 par.3 te KPRK-se dhe veprës penale Mbajtja ne pronesi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 te KPRK-se, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit te akuzuarit , të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Peje, P.nr.104/16 të datës 30.11.2018 , në seancën e kolegjit të mbajtur më 25.Janar.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet, si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.S., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Peje, P.nr.104/16 të datës 30.11.2018, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Peje, me aktgjykimin P.nr.104/16 të datës 30.11.2018, të akuzuarin B.S., e ka shpallur fajtor për veprën penale Grabitja nga nenin 329 par.3 te KPRK-se, për të cilën i ka shqiptuar dënimin me burgim me kohëzgjatje prej 3 vite si dhe dënim me gjobe ne shume prej 500 Euro, dhe për veprën penale Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 te KPRK-se, për të cilën i ka shqiptuar dënimin me gjobe ne shume prej 500 Euro, e ne baze te nenit 80 te KPRK-se i ka shqiptuar dënimin unik me burgim ne kohëzgjatje prej 3 vite e i cili dënim do te ekzekutohet pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit si dhe dënim me gjobe ne shume prej 1 mije Euro e te cilën gjobe është i obliguar qe ta paguaj ne afat prej 3 muajve pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit, e nëse nuk e paguan te njëjtën dënim me gjobe do ti zëvendësohet me dënim me burgim ku për çdo 20 euro do ti llogaritet 1 dite burgim.

Te dëmtuarit I.B. dhe Q.D. per realizimin e kërkesës pasuroro-juridike janë udhëzuar ne kontest civil.

I akuzuari është obliguar që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale që dalin sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 50€, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej 50€, e të cilat është i obliguar që t'i paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga i akuzuari janë konfiskuar Pistoleta e llojit Hadson e modelit 20, e kalibrit 4,5mm,- Diabolla me nr.serik 010611749 , e prodhimit Turk si dhe një paketim me plumba te llojit diabolla, si objekt i kryerjes së veprës penale, e te cilat do te shkatërrohen pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Mbrojtësi i te akuzuarit B.S.-av-V.SH. nga Gjakova, lidhur me vendimin mbi dënimin me burgim dhe me gjobë me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën, ashtu që ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë dhe të akuzuarit t'i shqiptoj një dënim më të ulët me burgim dhe me gjobe , e më të cilin dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.10/19, datë 04.01.2019, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.S. të refuzohet si e pabazuar , ndërsa aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK-së, në të cilën prezantuan i akuzuari B.S., mbrojtësi i te akuzuarit – Avokati H.L. te cilin gjykata e caktoi sipas detyrës zyrtare e me pëlqimin e te akuzuarit ngase nuk prezentoj mbrojtësi i te akuzuarit –avokati V.SH. edhe pse i njoftuar ne menyre te rregullt,mungoi edhe prokurori i apelit si dhe te dëmtuarit I..B dhe Q.D. ,andaj seanca e kolegjit u mbajte në pajtim me nenin 390 par.4 të KPRK-së. I akuzuari si dhe mbrojtësi i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare mbeten pran pretendimeve nga ankesa e ushtruar me shkrim duke propozuar qe te aprovohet e njëjta.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar:

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin aktgjykim

sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës se nenit 394 të KPPRK-së dhe konstatoj se i njëjti aktgjykim nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuarit.

Poashtu as gjendja faktike nuk ka qene objekt vlerësimi i kësaj gjykate ngase i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprat penale për te cilat ka qene i akuzuar ,siç parashihet me dispozitat e 248 te KPRK-së, e i cili pranim i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden ne shkresat e lendes dhe është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari pas konsultimit me mbrojtësin e tij .

Ndërsa sipas pretendimit ankimor të mbrojtësit te akuzuarit që ka të bëjë me vendimin lidhur me sanksionin penal – *neni 383 par.1 nën par 1.4 të KPPK-së*, kjo gjykatë e vlerëson si të pabazuar, për arsye se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit ka marr për bazë të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, të cilat mbrojtësi i te akuzuari i cek në ankesë si: pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit, shprehjen e sinqertë te pendimit për veprat penale të kryera, kërkim faljen ndaj te dëmtuarve, nivelin e ulet arsimor dhe gjendjen e rende ekonomike e të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e te cilat rrethana lehtësuese Gjykata e shkalles se pare i ka pasur parasysh ndërsa si rrethane renduese ka marre se i akuzuarin është recidivist, andaj Gjykata e Apelit konsideron se pretendimet ankimore lidhur me vendimin mbi dënimin nuk janë te bazuara dhe se me dënimin e shqiptar nga ana e Gjykatës se shkalles se pare do te arrihet qëllimi i dënimit i parapare me nenin 41 te KPRK-se dhe se dënimi i shqiptuar është ne përpjesëtim me peshën e veprave penale te kryera dhe përgjegjësinë penale te kryesit.

Nga të cekurat më lartë e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr. 624/18 dt. 25.01.2019

Procesmbajtësja

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit,

Syzana Goxhuli

Abdullah Ahmeti

Xhevdet Abazi

Afrim Shala
